

VENDIM
Nr.677, datë 3.10.2007

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.642, DATË 11.10.2005 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR KËSHILLAT MBIKËQYRËS TË SHOQËRIVE
ANONIME SHTETËRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 e 18 të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.642, datë 11.10.2005 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas shkronnjës “b” të pikës 1, shtohet shkronja “c”, me këtë përmbajtje:
“c) Për shoqëritë anonime të ujësjellës-kanalizimeve, gjashtë anëtarë. Në raste të veçanta dhe të justifikuara, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës mund të caktojë, për këto shoqëri, një numër më të vogël anëtarësh.”.
 2. Pas paragrafit të fundit të pikës 2, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:
“Mënyra e propozimit të anëtarëve të këshillave mbikëqyrës të shoqërive anonime të ujësjellës-kanalizimeve përcaktohet në statusin e këtyre shoqërive.”.
 3. Në fund të pikës 3 shtohet një fjali, me këtë përmbajtje:
“Emërimi i anëtarëve të Këshillave Mbikëqyrës të shoqërive anonime të ujësjellës-kanalizimeve përcaktohet në statusin e këtyre shoqërive.”.
 4. Në pikën 4 fjalët “...mund të...” hiqen.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha